



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna Klinë

Debat me Publikun

01N 06 /18 -8536/18

Klinë, 17.12.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Debat me Publikun e mbajtur më 17.12.2018 në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën 10:00.

Rëndi i Ditës

1. Konsultime lidhur më Projekt-Rregullorën komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale
2. Konsultimet lidhur me Draft-Statutin e Qëndres për pun Sociale
3. Konsultimet lidhur me Draft-Ndryshimet të rregullores në tatimin e Pronës së Palujtshme

Në mbledhje ishin prezent:

Fadil Gahi.....Kryesues

Binak Sylja.....Drejtor i Administrates

Naser Morina ...Drejtor për Bujqësi

Aziz Desku...Drejtor për Ekonomi dhe Financa

Arben Limanaj...Drejtor i Arsimit

OJQ"KOHA"-Florida Gashi

KFOR, OSBE-Driton Marku

Si dhe 26 pjesëmarrës tjerë qytetar te komunës sonë

Debatin me Publikun e hapi Fadil Gashi fillimisht pëshshendeti të gjithë të pranishmit, lexoj pikat e rëndit të ditës, falënderoj grupin punues për përgatitjen e kësaj draft-rregullorja kërkoj nga qytetaret qe te lexojnë si dhe për çdo vërejtje apo sugjerim, për përgatitjen përfundimtare te kësaj

Draft-Rregulloreje e cila do te hedhet ne votim me 28.12.2018 te cilën shpresojmë qe do ta miratojmë, fjalën i jep Aziz Deskut.

Aziz Desku-theksoj se lidhur me tarifat, ngarkesat dhe gjobat Komunale janë disa arsye

Ne kuvendin komunal ka pasur kërkesë nga Valmir Bacaj për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores se tarifave komunale për disa dokumente te gjendjes civile te cilat janë me te larta sesa parashihen më rregulloren.

Dy nga viti 2014 kur edhe aprovuar rregullorja për tarifat ngarkesa te cilat janë ne fuqi, janë ber disa herë ndryshime dhe plotësime por që nuk janë inkorporuar ne projekt-rregullore e cila është në fuqi.

Kemi ulur tarifat për bizneset për 20 % duke ja lehtësuar punën e të bërit biznes, kemi ulur tarifën e certifikatave, është formuar grupi punues me ne krye Ajet Sejdiu, tani kërkoj nga qytetaret të paraqesin kërkesat e tyre për tarifat ngarkesat dhe gjobat komunale.

Arben Limani theksoj se drejtorja e Arsimit ka propozuar disa tarifa të cilat janë të nxjerra nga ana e MASH-it, theksoj se dokumentet dublikate me udhëzimin administrativ kanë qen 1 euro ndërsa deri tash kjo është paguar 5 euro ka mbetur te bisedohet për vlerat tarifore për dëftesat e shkollës se mesme, kërkojmë te mbetet siç ka qene. Për regjistrimin e arsimit shkollor për te rritur regjistrimi është 100€, për praktik profesionale është vlera 50€ për provime diferenciale 10 për diploma dhe për shfrytëzimin e hapësirave shkollore 10€ për orë.

Florida Gashi nga OJQ "KOHA"-Ka një aneks për panit te cilat janë te shumta ato qe janë vendosur pyet drejtorin e Inspektoratit se a ka marr ndonjë veprim, tregon se dy prej tyre në të kaluarën edhe kanë ren nga erërat, gjithashtu pyeti se a është marr ndonjë veprim për kolonat që po behën në shesh për shkake te punimeve rreth ndriçimit të sheshit?

Fadil Gashi Kërkoj qe te folet për gjobat dhe tarifat, kërkoj propozim konkret nëse keni kërkesa ju lutem.

Dodë Preni kërkoj që materialet tu dërgohen disa ditë më herët për lexim, si dhe moslejimi i ekipeve oborret shkollore për shkake se ne te kaluarën nuk ka qenë një gjë e mire.

Fadil Gashi arsyeja e mos dërgesës është se nuk jemi te informuar për pjesëmarrjen e qytetarëve ne debat se cilët vijnë dhe cilët jo.

Pika e dytë-

Konsultimet me Draft-Statutin e Qendrës për Punë Sociale.

Ilir Bacaj njoftoj se komisioni i përberë prej 5 te cilët 3 janë nga Qendra për Punë Sociale 1 nga zyra ligjore dhe një nga kuvendi komunal e ka përfunduar punën për këtë Draft-Statut, me këtë Draft-Statut do te ruhet konfidencialiteti, rregullohet mbikëqyrja e brendshme struktura organizative, organizimi, sindikata si dhe do të rregullohen kompetencat ligjore brenda këtij institucioni. Presim nga ju ndonjë vërejtje apo sugjerime.

Pika e tretë.

Draft-ndryshimet e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme

Miftar Krasniqi-zyrtar -kemi kërkuar nga ministria që te na ndihmoj dhe lehtësoj procedurat e ndryshimit të ndërrimit të pronarit tjetërsimit të pronës e ne veçanti për ata që tash nuk jetojnë që 50-100 vite dhe janë në emrin e tyre prona të ndryshme dhe aty ku nuk ka pengesë të bartim tek ata që janë pasardhës, tatimi për tokë vitin e parë do të jetë 20% e vlerës së tokës, vitin e dytë do të jetë 40%, janë të parapara njësit bujqësore 0.15-0.5 për njësit pyjore 0.15-0.8, njësit rezidenciale objekte banimi ashtu siç ka qenë 0.15-1%.

Aziz Desku tha se në si komunë do të shkojmë me normën me të ulët që na lejon ligji.

Fadil Gashi theksoj se ligji i obligon komunat që të zbatoj rregulloren nga viti janari 2019 me kaq po e përfundoj këtë mbledhje faleminderit për pjesëmarrje.

Debati me publikun përfundon me punë në orë 11:00

Procesmbajtësi
Ahmet Berisha

Berisha



Kryesuesi
Fadil Gashi

Fadil Gashi